Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 098/2026
Datë: 02.11.2026

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 (3 dhe 10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 9 (1.3 dhe 1.4), nenin 12, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Edona Podrimja, emërohet Zëvendësministre në Ministrinë e Shëndetësisë.

2. Zëvendësministrja emërohet për mbështetjen e Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe është përgjegjëse për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.

3. Znj. Podrimja, është e obliguar të bëjë deklarimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:
- *Znj. Edona Podrimja, Zëvendësministre në MSh;*
- *Zëvendëskryeministrave;*
- *Ministrave;*
- *Shefes së stafit të Kryeministrit;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;*
- *Arkivit të Qeverisë.*